



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

**RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK
TË PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.
10093, DATË 9.03.2009, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE”.**

1. Titulli i projekt-aktit

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10093, datë 9.03.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10093, datë 9.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publik, nga data 25.02.2026 dhe është mbyllur në datë 25.03.2026 .

3. Metodat e konsultimit

Për konsultimin publik të projektligjit “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10093, datë 9.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”, numri i shikimeve në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ishte 612 dhe numri i komenteve 0.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka zhvilluar procesin e konsultimit publik nëpërmjet:

- Publikimit të projektaktit më datë 25 shkurt 2026, në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike;
- Publikimit në website zyrtare të MSHMS-së të projektaktit datë 25 shkurt 2026 dhe paketës shoqëruese;
- Takime dhe komunikime me institucionet, institucionet e pavarura, organizatat e/për institucionet e pavarura.

4. Palët e interesuara të përfshira

Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10093, datë 9.03.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”, në kuadër të konsultimit publik kanë ardhur komente, nëpërmjet e-mailit zyrtar, sugjerime dhe komente nga:

- Organizata “World Vision”
- Partnerët Shqipëri për ndryshim dhe Zhvillim
- Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim, SCiDEV
- Nisma për ndryshim Shoqëror ARSIS
- Shoqata “Përtej Barrierave”
- Hand to Hand Against Nation Apathy- H.A.N.A
- Kryqi i Kuq Shqiptar

Komentet dhe sugjerimet janë dërguar përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me shkrim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në vijimësi, projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, si dhe në Departamentin e Administratës Publike. Mbas reflektimit të komenteve projektligji është bashkërenduar në vijim me ministrinë e linjës.

Projektligji ka për qëllim miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në Ligjin nr. 10093, datë 9.03.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”, që do të sjellin si rezultat rritjen e efikasitetit institucional dhe ndërveprimin me shoqërinë civile si aktorë kryesorë në zhvillimin e një shoqërie demokratike.

Lidhur me komentet e përcjella nga shoqëria civile disa janë mbajtur në konsideratë dhe janë reflektuar në përmbytje të projektligjit, sugjerime që përmirësojnë cilësinë e projektligjit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Commented [SK1]: Lutem pasqyroni komentet e mbledhura

<u>Cështja</u> _____ e <u>adresuar</u> <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<u>Komenti</u> <i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<u>Palët e interesuara</u> <i>a (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<u>Vendi</u> <u>mi (I</u> <u>pranuar</u> <u>/</u> <u>pranuar</u> <u>pjesëris</u> <u>ht/I</u> <u>refuzua</u> <u>r)</u>	<u>Justifikimi</u>